

## KONTRATE

**PER THEMELIMIN E SHOQERISE TREGETARE  
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

### Tirana Cash & Carry sh.p.k.

#### Midis Shtetasve:

1. **Vullnet SINAJ**, i biri i Ruzhdiut, i dtl. 1965, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, Rr. Naim Frasheri, lagjia 9, pall.47, shk.2, ap.29. Me dokument identifikimi ( pasaporta ) Nr. Z0597572 .
2. **Albert JANINA**, i biri i Vangjelit, i dtl. 1966, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, Rr. Labinoti, Filipeu 2 . Me dokument identifikimi ( pasaporta ) me Nr. Z0540660.
3. **Edmond GJIKOKAJ**, i biri i Janit, i dtl. 1966, lindur dhe banues ne Vlore Lagjia Partizani, Rr. Ali Demi, Nr.13. Me dokument identifikimi ( pasaporta ) Nr. Z 0624852.

Te tre madhore dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, ne baze te legjislacionit shqipetar kane vendosur me vullnetin e tyre te lire dhe te plete , arrijne marreveshjen per themelimin e shoqerise tregetare private, me pergjegjesi te kufizuar, te emertuar **Tirana Cash & Carry Sh.p.k.** e cila do te rregullohet ne mbeshtetje te ligjes Nr. 7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit " te ligjes 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare " , liges 7667 date 28.01.1993 " Per rregjistrin Tregetar " , si dhe te legjislacionit shqipetar ne fuqi dhe normave qe vijojne :

#### Neni 1

Te themelojne nje shoqeri tregetare me pergjegjesi te kufizuar e quajtur **Tirana Cash & Carry Sh.p.k.**

**Tirana Cash & Carry** eshte nje subjekt juridik Shqipetar, te cilit i lind e drejta te ushtroje aktivitetin qe nga data e rregjistrimit ne Rregjistrin tregetar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Shoqeria **Tirana Cash & Carry** zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin Shqipetar dhe me aktet e themelimit te saj.

#### Neni 2

Shoqeria do te jete e formes se Shoqerive tregetare me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbjet deri ne kusirin e vleres te kontributit te derdhur ne kapitalin themelor.

#### Neni 3

Objekti i aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete:

- Import – eksport , tregetimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve , me shumice dhe pakice si :
- Tregetim artikuj te ndryshem industriale .
- Tregetim artikuj te ndryshem ushqimore .
- Tregetim artikuj te ndryshem bujqesore e blegtoreale .
- Tregetim fruta - perime .
- Tregetim automjetesh te cdo lloji , marke e tonazhi , si dhe pjesa kembimi per to .
- Tregetimin me shumice e pakice te mjeteve, paisjeve dhe medikamenteve mjekesore, elektro – mjekesore .
- Hapje pike lavazho, servisi .
- Tregetim, montim, riparim paisjesh elektro - shtepiake , elektronike , elektrike , kompjuterike , higjeno - sanitare dhe hidraulike , prodhime qeramike , artizanati , paisje zyrash etj
- Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit
- Transport personash brenda dhe jashte vendit .
- Tregetimin e materialeve te ndertimit e lendeve te para , inerte te ndryshme , brenda dhe jashte vendit .
- Hapje agjensi turistike.
- Hapje agjensi imobiliare.
- Hapje dhe shfrytezim hotelesh , motelesh, diskotekash, lojra argetuese per femije , qender sportive , qendra pushimi e kurative .
- Tregetim prodhimesh kozmetike e estetike .
- Tregetimin e karburanteve te ndryshme me pakice, si dhe vajrave lubrifikante, te gazit te lengshem per ngrohje, paisje ngrohese gazi si dhe mbushjen e bombolave te gazit dhe tregetimin e tyre me pakice .

#### Neni 4

Shoqeria **Tirana Cash & Carry** e ka seline e saj ne **Tirane , Rr. Kavajes, Ambjentet e ish – Kombinatit Misto Mame** . Ajo ka te drejte te krijoje brenda dhe jashte teritorit te Republikes se Shqiperise, filiale, agjensi perfaqesi, seli sekondare , dege ne menyre ambulatore, me njesi apo duke hapur zyra ,si dhe ti suprimoje ato.


#### Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise **Tirana Cash & Carry** eshte **230.000 Euro** dhe eshte i perbere nga shuma ne te holla e derdhur nga ortaket.

#### Neni 6

Palet kontraktuese kane rene dakort te percaktojne kuoten e pjesemarrjes te seicilit ortak sime poshte:

Vullnet	SINAJ .....	51 % ( pesedhjete e nje )
Albert	JANINA .....	30 %( tridhjete )
Edmond	GJIKOKAJ .....	19% ( nentembedhjete )



Percaktohet ketu se ortaket kane te drejte te kontrobuojne ne kuoten e tyre te pjesemarrjes,duke transferuar ne pronesi te shoqerise **Tirana Cash & Carry** te mira meteriale.

#### Neni 7

Kohezgjatja e shoqerise **Tirana Cash & Carry** Sh.p.k. do te jete me afat te pacaktuar e mbi 10 vjetë. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te asamblese se ortakeve .

#### Neni 8

I gjithe kapitali themelor eshte i ndare ne 100 pjesë te barabarta ku sejçila pjesë eshte e perbere nga 2300 euro .

I gjithe kapitali i vene nga te katert ortaket themelues eshte teresisht dhe plotesisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem nga ana e tyre.

#### Neni 9

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne shoqerine tregetare **Tirana Cash & Carry** Sh.p.k. do te shenohet dhe kapitali i derdhur nga te tre ortaket . Rritja e kapitalit themelor te shoqerise nuk eshte e kufizuar .

#### Neni 10

Te ardhurat e realizuara nga shoqeria do te ndahen pjeserisht ose totalisht ndermjet ortakeve sipas kuotave te tyre te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar pasi te jete lene nje shume menjane te pakten sa nje e njezeta e tij e cila destinohet per formimin e fondit rezevre.

#### Neni 11

Ne kohen e prishjes se shoqerisae ose te perfundimit te afatit , kur nuk ka zgjatje afati kapitali i shoqerise pasi te hiqen debitet e saj do te ndahet proporcionalisht ndermjet ortakeve sipas kuoptave te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar .

#### Neni 12

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqerise , pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe ato qe kane lindur me te tretet, eshte plotesisht i transferueshem dhe per tu depozituar ne nje nga Bankat Shqipetare, ose per tu perdorur sipas nevojave te ortakeve te shoqerise

#### Neni 13

Ortaket kane keto te drejta dhe detyra themelore:

- te derdhin kuoten kapitalit baze sikunder eshte percaktuar ne nenin 6,
- te marri pjesë ne drejtimin e shoqerise,
- te terheqin fitimin e realizuar,

- te terheqin aktivin resultant nga bilanci i likujdimit ne rast te pushimit te aktivitetit te shoquerise,
- te ruajene sekretin e aktivitetit te shoquerise,
- te impenjohen per arritjen e objektivave te shoquerise.

#### Neni 14

Organet e shoquerise **Tirana Cash & Carry Sh.p.k.** jane:

- Asamblea e Ortakeve te shoquerise
- Administratori i shoquerise.

Modalitetet e formimit dhe funksionit te tyre do te percaktohen ne statutin e shoquerise.

Administrator i shoquerise do te jetë **Z. Edmond GJIKOKAJ**.

#### Neni 15

Shoqeria tregetare private **Tirana Cash & Carry sh.p.k.** eshte person juridik shqipetar dhe do te ushtroje veprimtarine e saj ekonomike private ne baze te legjislacionit shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht ligjeve 7512 date 10.08.1991, 7638 date 19.11.1992, 7667 date 28.01.1993, te K. Civil si dhe te akteve ligjore dhe nenligjore te dala ne zbatim te tyre

#### Neni 16

Marredheniet e punesimit ne shoqeri di te rregullohen nepermjet kontartes se punes qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te ligjit 7961 date 12.07.1995 ( Kodi i Punes ), si dhe akteve te tjera ne zbatim te tij .

#### Neni 17

Mosmarreveshjet e mundeshme qe mund te lindin gjate interpretimit apo zbatimit te kesaj kontrate palet do ti zgjidhin ne rruge miqesore ne te kundert kompetencia per zgjidhjen e konfliktit i kalon Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

#### Neni 18

Per sa nuk pershkruhet ne kete kontarte themelimi do te aplikohen nenet e statutit te shoquerise dhe dispozitat e legjislacionit shqipetar .

#### Neni 19

Kjo kontrate eshte perpiluar ne kater kopje origjinale.

Vullnet SINAJ Vullnet Janaj Albert JANINA Albert Janina


Edmond GJIKOKAJ Edmond Gjikokaj

# STATUT

## I SHOQERISE TREGTETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### Tirana Cash & Carry SH.P.K.

Shoqeria **Tirana Cash & Carry** eshte e krijuar mbi bazen e kontrates midis tre ortakeve themelues te saj :



1. **Vullnet SINAJ**, i biri i Ruzhdijut, i dtl. 1965, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, Rr. Naim Frasher, lagjia 9, pall.47, shk.2, ap.29. Me dokument identifikimi ( pasaporta ) Nr. Z0597572 .
2. **Albert JANINA**, i biri i Vangjelit, i dtl. 1966, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, Rr. Labinoti, Filipeu 2 . Me dokument identifikimi ( pasaporta ) me Nr. Z0540660.
3. **Edmond GJIKOKAJ**, i biri i Janit, i dtl. 1966, lindur dhe banues ne Vlore Lagjia Partizani, Rr. Ali Demi, Nr.13. Me dokument identifikimi ( pasaporta ) Nr. Z 0624852.

Statuti eshte akti baze ku do te mbeshtetet themelimi i shoqerise tregetare private **Tirana Cash & Carry sh.p.k.** me pergjegjesi te kufizuar si dhe zhvillimi i metejshem i veprimtarise se saj .

Per te bere te mundur veprimtarine ekonomike dhe organizimin e kesaj shoqerie ne perputhje me ligjin 7512 date 10.08.1991 , 7638 date 19.11.1992, si dhe 7667 date 28.01.1993 eshte perpiluar ky statut me kerkesat e ligjes per shoqerite tregetare me pergjegjesi te kufizuar .

#### Neni 1

#### EMERTIMI

Shoqeria eshte quajtur **Tirana Cash & Carry Sh.p.k.**

Ajo eshte nje subjekt juridik Shqipetar, te cilit i lind e drejta te ushtroje aktivitetin qe nga data e Rregjistrimit ne Rregjistrin tregetare prane Gjykates se Rrethit Gjiqesor Tirane. Shoqeria **Tirana Cash & Carry** zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin Shqipetar dhe me aktet e themelimit te saj (kontrata dhe statuti).

#### Neni 2

#### OBJEKTI

Objekti i aktivitetit ekonomik te shoqerise **Tirana Cash & Carry** do te jetë:

- Import – eksport , tregetimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve , me shumice dhe pakice si :
- Tregetim artikuj te ndryshem industriale .
- Tregetim artikuj te ndryshem ushqimore .

- Tregetim artikuj te ndryshem bujquesore e blektorale .
- Tregetim fruta - perime .
- Tregetim automjetesh te cdo lloji , marke e tonazhi , si dhe pjese kembimi per to .
- Tregetimin me shumice e pakice te mjeteve, paisjeve dhe medikamenteve mjekesore, elektro – mjekesore .
- Hapje pike lavazho, servisi .
- Tregetim, montim, riparim paisjesh elektro - shtepiake , elektronike , elektrike , kompjuterike , higjeno - sanitare dhe hidraulike , prodhime qeramike , artizanati , paisje zyrash etj
- Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit
- Transport personash brenda dhe jashte vendit.
- Tregetimin e materialeve te ndertimit e lendeve te para , inerte te ndryshme , brenda dhe jashte vendit .
- Hapje agjensi turistike.
- Hapje agjensi imobiliare.
- Hapje dhe shfrytezim hotelesh , motelesh, diskotekash, lojra argetuese per femije , qender sportive , qendra pushimi e kurative .
- Tregetim prodhimesh kozmetike e estetike .
- Tregetimin e karburanteve te ndryshme me pakice, si dhe vajrave lubrifikante, te gazit te lengshem per ngrohje, paisje ngrohese gazi si dhe mbushjen e bombolave te gazit dhe tregetimin e tyre me pakice .

#### Neni 3

Per kryerien e veprimtarise se saj Shoqeria do te hapi njesi grumbulluese, perpunuese, sherbimi e tregetuese, si dhe do te bashkpunoj me persona fizike e juridike, vendas ose te huaj .

#### Neni 4

##### SELIA

Shoqeria **Tirana Cash & Carry** e ka seline e saj ne **Tirane , Rr. Kavajes, ambjentet e ish – Kombinatit Misto Mame** . Ajo ka te drejt te krijoje brenda dhe jashte teritorit te Republikes se Shqiperise, filiale, agjensi perfaqesi, seli sekondare si dhe ti suprimoje ato.Cdo ndryshim i selise do te behet me vendimin e asamblese se ortakeve te shoqerise .

#### Neni 5

##### KOHEZGJATIA

Shoqeria do te kete nje kohezgjatie me nje afat te pacaktuar e mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbeht ne cdo kohe me vendim te Asamblese se Ortakeve

#### Neni 6

##### KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **230.000 Euro** dhe eshte i perbere nga shuma ne te holla e derdhur nga ortaket.

#### Neni 7

Palet kontraktuese kane rene dakort te percaktojne kuoten e pjesemarrjes te seicilit ortak sime poshte:

**Vullnet SINAJ ..... 51 % ( pesedhjete e nje )**  
**Albert JANINA ..... 30% ( tridhjete )**  
**Edmond GJIKOKAJ ..... 19 % ( nentembedhjete )**

Percaktohet ketu se ortaket kane te drejte te kontribuojne ne kuoten e tyre te pjesemarrjes,duke transferuar ne pronesi te shoqerise **Tirana Cash & Carry** te mira meteriale.

#### **Neni 8**

I gjithe kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjesa te barabarta ku sejcila pjesa eshte e barabarte me nga 2300 euro .

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane teresisht dhe plotesisht te shlyeshme dhe te nenshkrueshme nga te tre ortaket themelues .

#### **Neni 9**

Transferimi i kuotave behet vetem me akt notarial. Cdo transferim i kuotave tek te tretet i nenshtrohet te drejtes se parablerjes nga ortaku tjeter  
Kuat e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve . Ortaku qe ka ndermend te cedoje kuotat e veta , perpara duhet ti komunikojte shoqerise projektin e transferimit . I takon ortakut tjeter te shoqerise te ushtroj te drejten e parablerjes .  
Nese shoqeria nuk jep pernjigje brenda nje muaji nga marria e projektit te transferimit , miratimi konsiderohet i dhene . Nese ortaket duan te blejne , te ushtrojne te drejten e parablerjes, ata duhet te ushtrojne kete te drejte brenda nje muaji nga marria e projektit te transferimit . ne rast te kundert ata duhet te lejojne transferimin e kuotave te treteve .

Kushtet e ofruara te treteve nuk duhet te jene me te favoreshme nga ato te ofruara ortakeve .

Ne rast se lind nevoja per vleresimin e kuotave, ortaket caktojne ekspert . Ne rast se nje gje e tille nuk arrihet prej tyre, caktimi i ekspertit behet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane .

#### **Neni 10**

Shoqeria mund te rrisi kapitalin themelor , ose mund ta zvogeloje ate , por gjithnje jo nen kufirin 100.000 leke, qe percaktohet ne ligjin 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare " me perjegjesi te kufizuar .

Shtimi ose pakesimi i kapitalit behet me vendim te Asamblese se ortakeve dhe sipas kerkesave te Ligjes .

#### **Neni 11**

Pjeset e kapitalit themelor jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie, ne rast ndarie pasurore nermijet bashkeshorteve, paraardhesve e pasardhesve . Ne rast vdekie te ortakut pjeset e kapitalit themelor qe ai disponon i kalojne trashegimtareve



te tij, dhe kur asnjeri nga pjesetaret e familjes nuk pranon te punoje ne ortakeri, atehere u jepen te gjitha fitimet qe i takojne sipas kontributit te derdhur ne kapitalin themelor  
Trashegimtari hyn ne shoperi me te gjitha te drejtat e detyrimet perkatese te ortakut .

#### Neni 12

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarise ekonomike i Shoqerise do te administrohet nga ortaket e shoqerise . Nje pjese e ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregetar . shoqeria eshte e detyruar te shlyeje te gjitha detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve .

#### Neni 13

Shoqeria eshte disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj . Ajo mund te bleje e te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tretet .

Ne Republiken e Shqiperise **Tirana Cash & Carry sh.p.k.** gezon te drejta sikunder cdo person tjeter juridik ose fizik shqiptar ose i huaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi

#### Neni 14

Shoqeria ka te hapur llogarine e saj rrjedhese ne Banke, nepermjet se ciles kryen veprime ekonomike financiare me partner te trete vendas dhe te huaj, duke likujduar me monedhe shqipetare apo te huaj, sipas marreveshieve te perfunduara midis tyre .

#### Neni 15

Organet drejtuese te shoqerise jane :

Asambleja e ortakeve

Administratori i Shoqerise

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimor i shoqerise . Ajo mund te jetet e zakoneshme ose e jashtezakoneshme . Asambleja e zakonshme thirret te pakten dy here ne vit, pas mbylljes se vitiit finanziar, dhe kur aprovohet programi i veprimtarise per vitin e ardhshem .

Asambleja e jashtezakoneshme thirret kur administratori i shoqerise e quan te pershtateshme per kerkesat e shoqerise . I takon asamblese te jashtezakoneshme te beje , ndryshime ne Statutin e shoqerise, te pakesoj ose shtoj kapitalin themelor . Te shperndaj para afatit Shoqerine, ose te shtyje aktivitetin e saj.

#### Neni 16

Asambleja e ortakeve drejtohet nga Administratori i shoqerise . I takon ketij te fundit te verifikoj rregullshmerine e pjesemarrjes se ortakeve . Cdo ortak mund te perfaqesohet ne Asamble nga nje tjeter ortak me ane te nje akti me delegim te nenshkuar sipas firmes se depozituar ne librin e ortakeve .

Per te mbajtur procesverbalin e mbledhjeve te Asamblese caktohet nje sekretar , qe mund te jetet edhe nje noter . Vendimet e Asamblese duhet te nenshkuhen nga Administratori i Shoqerise, nga sekretari dhe nga te gjithe pjesemarresit .

Vendimet e Asamblese te marra ne perputhje me ligjin dhe me kete statut jane te detyrueshme per te gjithe ortaket prezent ose jo .

#### Neni 17

Organi administrator i shoqerise eshte Administratori i shoqerise . Ai zgjidhet nga asambleja e ortakeve dhe qendron ne detyre per gjithe kohezgjatjen e aktivitetit , pervec rasteve te nje revokimi eventual nga vet Asambleja e Shoqerise .  
Administrator i shoqerise **Tirana Cash & Carry sh.p.k.** u caktua Z. **Edmond GJIKOKAJ** .

#### Neni 18

Administratorit te shoqerise i takon administrimi i zakonshem i shoqerise pervecse kur kjo gje sipas ligjes apo Statutit i rezervelet Asamblese se Ortakeve . I takon Administratorit te Shoqerise te perfaqeson Shoqerine perpara te treteve dhe ne gjykim . Ai gezon te drejten e firmes se shoqerise . Administratori mund ti delegoj te drejtat e veta nje personi te trete te autorizuar me shkrim per te perfaqesuar shoqerine si ~~edhe te~~ kryej veprime dhe praktika te ndryshme ne emer te tij .

#### Neni 19

Asambleja e ortakeve te shoqerise ka keto kompetencia e te marre keto vendime : Te miratoj programin e veprimtarise se Shoqerise, te hartoj raportet e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore . Vendos per shperndarien e shoqerise, per ndarien e fitimit dhe mbulimin e humbieve . Rregullon marredheniet e punesimit dhe ato te shperblimit brenda shoqerise . Emeron dhe shkarkon administratore , eksperte kontabel . Ben ndryshime e plotesime ne statut dhe ne kontraten e themelimit, vendos per rritjen ose zvogelin e kapitalit themelor, kalimin e kapitalit te treteve, ndryshimin e kohes se veprimtarise, shnderrimin e shoqerise ne nje forme tjeter , likujdimin e shoqerise . Sipas akteve ligjore ben shlyerien e detyrimeve ndaj organeve shteterore , personave juridik ose fizike , vendas e te huaj .

#### Neni 20


Kontrolli finanziar i shoqerise kryhet nga nje ose me shume ekspert kontabel te autorizuar ose te emeruar nga asambleja e ortakeve me nje afat prej tre vitesh financiare te njepasnjeshme me mundesi riemerimi .

#### Neni 21

Cdo vit finanziar fillin ne 1 janar te cdo viti dhe perfundon ne 31 dhejtor te cdo viti , me perjashtim te vitiit te pare ku si fillim eshte data e rregjistrimit te shoqerise .

#### Neni 22

Llogarite vjetore , inventaret , reporti mbi operacionet e vitiit finanziar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret apo eksopertet kontabel miratohet nga



asambleja e ortakeve . Miratimi i dokumentave financiare vjetore behet brenda nje afati 3 - m妖or, mbas dates se shlyerjes se vitit finanziar .

#### Neni 23

Mbas miratimit te llogarive vjetore dhe vertetimit te ekzistences se fitimit Asambleja e ortakeve vendos e krijon fondin ligjor, por mund te krijoje edhe fonde te tjera . Shoqeria per gjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se sigurimeve shoqerore etj. Ajo ka te drejte te celi llogari likujduese prane Bankave te vendit dhe te kryeje veprimtari likujduese nepermjet tyre .

#### Neni 24

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbaron ne 31 dhjetor te cdo viti . Administratori ose personat e caktuar prej tij jane te detyruar te paraqesin bilancin vjetor dhe deklaraten e te ardhurave e ti depozitojne ne Organin financier te Zyres se Tatimeve .

#### Neni 25

Marredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen nepermjet kontartes se punesimit qe lidhet midis paleve ne perputhje me ligjin 7961 date 12.07.1995 ( Kodi I Punës ) si dhe legjislacionit tjeter shqipetar qe ben fiale per punesimin .

#### Neni 26

Marrja ne pune behet me rregjistrimin nga punedhenesi ne librin e punes se shoqerise si dhe duke njofuar organet e punes se juridiksonit ku ushtron veprimtarine shoqeria Largimi nga puna ose ndryshimi i vendit te punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga administratori i shoqerise . Largimi lidhet me mbarimin e kontartes se punes, per shkelje disiplinore, ose edhe me vete kerkesen e te interesuarit . Largimi nga shoqeria behet pasi jane shlyer te gjitha detyrimet materiale e monetare .

#### Neni 27

Shoqeria mund te lidhi kontarata me sektore shteterore drejtperdrejt ne tregun e lire si dhe me persona fizike ose juridike , vendas ose te huaj . Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqesohet nga administratori i shoqerise z. **Edmond GJIKOKAJ** . Ajo mund te perfaqesohet edhe nga persona te tjere te percaktuar prej tij me prokure . Te drejtat e detyrimet qe rrjedhin nga kontartat jane te detyrueshme per shoqerine .

#### Neni 28

Shoqeria mund te prishet para aftit te caktuar ne kete statut ne rast kur ndryshon afati ose kur ka nje prishje te parakoheshme per shkaqe te tjera . Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj . Per kryerjen e ketij procesi emerohen nje ose disa likujdatore te cilet ndjekin operacionet e likujdimit deri ne fund dhe i paraqesin Asamblese se ortakeve rezultatet perfundimtare te likujdimit . Ne perfundim Asambleja e ortakeve vendos per heqjen e mandatit te tyre .

Te gjitha detyrimet qe dalin nga akti i likujdimit Asambleja e ortakeve i merr persiper per ti shlyer me kapitalin e ortakeve te shoqerise .

#### Neni 29

Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim brenda shoqerise si dhe shoqeria me te tretet apo midis vete ortakeve do te zgjidhen nepermjet Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ku eshte edhe rregjistri tregetar i shoqerise .

#### Neni 30

Ceshtjet e tjera te pa trajtuar ne kete statut do te mbeshteten per zbatim ne legiislacionin shqipetar ne fuqi, sipas rastit konkret, si dhe ne ligjin 7512 date 10.08.1991, ligjin 7638 date 19.11.1992, 7667 date 28.01.1993 dhe Kodit Civil si dhe akteve te tjera ligjore dhe nenligjore te dala ne zbatim te tyre .

#### Neni 31

Ndryshimi i formes se shoqerise ne nje shoqeri me forme tjeter behet me vendim te asamblese se ortakeve , kur plotesohet kushtet per krijimin e llojeve te tjera .

#### Neni 32

Asambleja e shoqerise mund te beje ndryshime e plotesime ne cdo kohe ne Statut e ne Kontarten e themelimit pa rene ndesh ne menyre thelbesore me nenet qe jane pershkruar ne kete statut .

Ndryshimet dhe plotesimet ne statut dhe ne kontraten e themelimit behen ne te njejten menyre e procedure me te cilin nxirret vete statuti .

#### Neni 33

Shoqeria do te kete vulen e saj me madhesi te zakonshme e me tekst perreth saj .

#### Neni 34

Statuti eshte hartuar me vullnetin e lire dhe te plete te paleve, te tre ortakeve themelues, dhe eshte neshkuar prej tyre .

Statuti redaktohet ne kater kopie per t'iu shperndare Organeve kompetente dhe nje kopie mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise .

Tirane, me 27.04.2006

#### ORTAKET THEMELUES

Vullnet SINAJ Vullnet Sina Glluz  
Albert JANINA Albert Janina  
Edmond GJIKOKAJ Edmond Gjikolaj  
